

Tregim Suksesi

POLIS avokon për të drejtën e gruas në pronë



Photo: POLIS nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Agjencinë për Barazi Gjinore

Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta Për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkëshortëve i cili ka hyrë në fuqi me datën 10 mars të vitit 2016. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ta bëj lirimin e tarifës së regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve në regjistrat publik. Periudha e zbatimit të këtij Udhëzimi fillimisht ka qenë një vjeçare.

Organizata Publike për Iniciativa Lokale dhe Mbështetje - POLIS, në kuadër të projektit “Angazhimi i përbashkët për të drejtat e grave me pronë të përbashkët” përkrahur nga Programi

Angazhimi për Barazi – E4E, po promovon të drejtat e barabarta në prone dhe ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm këtë Udhëzim. POLIS ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Agjencinë Për Barazi Gjinore që është në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ku përcaktohen veprimet koordinuese me qëllim të arritjes së synimeve të përbashkëta. Pas një analize rreth ndikimit të kësaj mase të realizuar nga POLIS është vërejtur se ndikimi i këtij Udhëzimi është i madh, e sidomos në komunën e Ferizajit.

Analiza me të dhëna është përcjellur në Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), me rekomandimin për vazhdimin e këtij Udhëzimi, të paktën edhe për një vit. ABGJ ka marrë parasysh rekomandimet dhe në bashkëpunim të ngushtë me POLIS kanë avokuar, duke kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vazhdimin e afatit të zbatueshmërisë së këtij Udhëzimi. Si rezultat, kjo masë është aprovuar nga Qeveria dhe do të vazhdojë deri me 27 prill 2018.

POLIS mbështetet në kuadër të programit Angazhimi për Barazi - E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.